



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 korrik 2023
Nr.ref.: RK 2238/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI77/22

Parashtrues

Nuredin Sylejmani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës
së Kosovës, Pml.nr.9/2022, të 19 janarit 2022**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nuredin Sylejmani me vendbanim të përhershëm në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml.nr.09/2022], e 19 janarit 2022, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [APS.nr.27/2021] e 22 tetorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit), si dhe Aktgjykimin [PS.nr.33/2020] e 22 prillit 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Vendimin e kontestuar e ka pranuar më 9 shkurt 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], dhe nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) dhe nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka kërkuar mos zbulim te identitetit të tij duke theksuar *“Për shkak të llojit të veprës penale për të cilën është dënuar parashtruesi i kërkesës do të paraqiste vështirësi risocializimi i tij në të ardhmen nëse identiteti i tij publikohet. Prandaj, Gjykatës i kërkojmë që të vlerësojë situatën për të ardhmen e parashtruesit dhe familjes së tij, pasi parashtruesi i kërkesës është mbajtës i familjes dhe vështirësitë në risocializimin e tij pas përfundimit të procedurave do të vështirësonin edhe ekzistencën e familjes, e cila që tani është e rënduar për shkak te burgimit që disa vite të parashtruesit.”*

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 6 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 8 qershor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr.KSH.KI77/22] e caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci – Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
9. Më 10 qershor 2022, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës, dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
10. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes se Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
12. Më 23 dhjetor 2022, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dorëzimin e dosjes së plotë të rastit.
13. Më 28 dhjetor 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e lëndës.
14. Më 25 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Nga shkresat e lëndës Gjykata verën se ndaj parashtruesit të kërkesës [dhe tre personave te tjerë] janë zhvilluar dy grupe procedurash: (I) procedurat sipas **Aktakuzës [PPS.nr.94/2013] së 23 janarit 2015**, të cilat kishin përfunduar me Aktgjykimin [APS.nr.8/2021] e 22 prill 2021, të Gjykatës se Apelit, dhe (II) procedurat sipas **Aktakuzës [PPS.nr.01/2018] së 5 gushtit 2020**, të cilat kishin përfunduar me Aktgjykimin [Pml.nr.09/2022], e 19 janarit 2022, të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës konteston vendimet e gjykatave të rregullta të zhvilluara në lidhje me **(II) Aktakuzën [PPS.nr.01/2018] e 5 gushtit 2020**, të cilat kishin përfunduar me Aktgjykimin [Pml.nr.09/2022], e 19 janarit 2022, të Gjykatës Supreme (Aktgjykimi i kontestuar).
16. Gjykata vëren se edhe pse parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës nuk i konteston procedurat, respektivisht vendimet e gjykatave të rregullta në lidhje me **(I) Aktakuzën [PPS.nr.94/2013] e 23 janarit 2015**, megjithatë parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij në lidhje me vendimet e kontestuara, i ndërlidhë me procedurat në lidhje me **Aktakuzën [PPS.nr.94/2013] e 23 janarit 2015**. Në këto rrethana, Gjykata në vijim do të paraqes fillimisht faktet në lidhje me **(I) procedurat sipas Aktakuzës [PPS.nr.94/2013] së 23 janarit 2015**, e më pas edhe faktet në lidhje me **(II) Aktakuzën [PPS.nr.01/2018] e 5 gushtit 2020**, procedurat, respektivisht vendimet e të cilave kontestohen pranë Gjykatës.

(I) Procedura sipas Aktakuzës [PPS.nr.94/2013] së 23 janarit 2015

17. Gjykata fillimisht sqaron se faktet e rastit sipas procedurës penale përkitazi me Aktakuzën [PPS.nr.94/2013] e 23 janarit 2015, janë marrë nga (i) *dosja e plotë e lëndës*, si dhe nga (ii) Aktgjykimi [KP.nr. 91/2022] i 20 prillit 2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes të cilit u ndryshua Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kolegjit Shqyrtues [KP.nr.373/2021] të 11 qershorit 2021 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special [PS.nr.33/2020] të 22 prillit 2021, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës dënim unik me burg në kohëzgjatje prej shtatë (7) vite e dhjete (10) muaj si dhe dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e tetëqind (1800.00) euro. Gjykata sqaron gjithashtu se Aktgjykimi [KP.nr. 91/2022] i 20 prillit 2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes të cilit u ndryshua Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kolegjit Shqyrtues [KP.nr.373/2021] të 11 qershorit 2021 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special [PS.nr.33/2020] të 22 prillit 2021 nuk kontestohet pranë kësaj Gjykate.
18. Nga shkresat e lëndës rezulton që Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim PSRK) kishte akuzuar parashtruesin e kërkesës se që nga muaji korrik 2013 deri më 5 nëntor 2013, duke vepruar në bashkëveprim, kishte përgatitur sulme

- terroriste në Kosovë dhe Maqedoni, ndaj objekteve të sigurisë, fillimisht ndaj burgut të Idrizovës, me qëllim të lirit të nga burgu të Sh.A., dhe sulmit ndaj Stacionit Policor në Prishtinë. Më 23 janar 2015, PSRK-ja ngriti Aktakuzën [PPS.nr. 94/2013] përmes të cilës parashtruesin e kërkesës [dhe disa persona të tjerë] e akuzoi për veprat penale: (i) përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, në bashkëkryerje, të përcaktuara në nenin 144, par.1 dhe 2, lidhur me nenin 31 të KPRK; dhe (ii) organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, nga neni 143, par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK; (iii) për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse, nga neni 372 paragrafi 1 dhe nenin 31 të KPRK-së; (iv) lehtësimi në kryerjen e terrorizmit, nga neni 138 paragrafi 1 të KPRK-së në lidhje me nenin 135 të KPRK-së, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve sipas nenit 374 paragrafi 1 i KPRK-së, sulmi nga neni 187 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
19. Më 22 janar 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit [PKR.nr.252/15] *liroi nga akuza* parashtruesin e kërkesës lidhur me veprat penale: (i) Përgatitja e veprave terroriste të kryera në bashkëkryerje nga neni 144 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 KPRK; (ii) Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, nga neni 143 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së; (iii) Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit, nga neni 138 paragrafi 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 135 të KPRK-së; ndërsa *shpalli fajtor* parashtruesin e kërkesës për veprat penale: (i) mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve sipas nenit 374 paragrafi 1 të KPRK-së; dhe (ii) importi, eksporti, furnizimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372, paragrafi 1 të KPRK-së; si dhe (iii) veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej *gjashtë (6) vite*, dhe dënim me gjobë në shume prej njëmijë e tetëqind (1800) euro.
20. Më 5 mars 2019, PSRK-ja paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal, si dhe vendimit mbi dënimin e shqiptuar, me propozimin që ta anulojë Aktgjykimin e ankimuar dhe ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.
21. Në vijim, më 21 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.150/2019] vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore lidhur me veprat penale nën pikën 1/III, 2/IV, 3/III, 4/I, 5/I, të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa anuloi vetëm për pjesën liruese të aktgjykimit për pikën 1/I dhe 1/II, që ka të bëjë me parashtruesin e kërkesës, si dhe për pikën 3/I dhe 3/IV, që kishte të bëjë me parashtruesin e kërkesës, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pa prekur.
22. Përfundimisht, më 4 nëntor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.276/19] anuloi Aktgjykimin [PKR.nr.252/15] e 22 janarit 2019, të Gjykatës Themelore, dhe Aktgjykimin [PAKR.nr.150/19] i 21 majit 2019, të Gjykatës së Apelit, për parashtruesin e kërkesës, "lidhur me veprën penale Sulmi nga neni 187 par.2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas dispozitivit 3/III, të aktgjykimit dhe për këtë çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ndërsa për pjesën tjetër të aktgjykimit mbetet i pandryshuar, ku në bazë të dispozitave të nenit 420 par. 1, par. 2 dhe 5 të KPPK-së, i janë ndryshuar këto aktgjykime të formës së prerë nga Kolegji Shqyrtues i kësaj gjykate sa i përket vetëm vendimit mbi dënimin me burg, ashtu që parashtruesit të kërkesës, i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në

paraburgim nga data 5 nëntor 2013 deri me 23 prill 2015, dhe i është shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e tetëqind (1800) euro.”

23. Më 11 dhjetor 2020, Gjykata Themelore ne rivendosje përmes Aktgjykimit [PKR.174/19] liroi nga akuza parashtruesin e kërkesës për veprën penale: (i) përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe lehtësimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 138 paragrafi 1 lidhur me nenin 135 të KPRK-së, si dhe është refuzuar akuza për sulm në bashkëkryerje nga neni 187 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale.
24. Kundër Aktgjykimit të lartcekur ushtroi ankesë PSRK, për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe (ii) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që parashtruesi i kërkesës të shpallet fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe t'a dënoj me dënim meritor sipas Kodit penal apo që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
25. Në anën tjetër përgjigje në ankesë parashtrroi edhe parashtruesi i kërkesës, me propozimin që ankesa e Prokurorisë Speciale të refuzohet si e pabazuar.
26. Më 5 mars 2021, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, Prokuroria e Apelit përmes parashtrësës [PPA/I.nr.107/22] propozoi që të aprovohet ankesa e PSRK-së, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe parashtruesi i kërkesës të shpallet fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe t'u shqiptohen dënime meritor ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
27. Më 22 prill 2021, Gjykata e Apelit, Departamenti Special, përmes Aktgjykimit [APS.nr.8/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e PSRK-së, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [PKR. Nr. 174/19] e 11 dhjetorit 2020, të Gjykatës Themelore.
28. Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës nuk i konteston pranë Gjykatës vendimet e lartpërmendura të gjykatave të rregullta e të ndërlidhura me Aktakuzën [PPS.nr.94/2013] së 23 janarit 2015. Megjithatë, Gjykata rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e kontestuar ndërlidhen me këto procedura, respektivisht vendime.

Procedura sipas Aktakuzës [PPS.nr.01/2018] së 5 gushtit 2020, përkitazi me Vendimin e kontestuar, përkatësisht Aktgjykimin [Pml.nr.09/2022], e 19 janarit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës

29. Nga shkresat e lëndës rezultojnë që parashtruesi i kërkesës, në kuadër të kësaj Aktakuze ishte akuzuar lidhur me veprimin e tij të shkuarjes në Siri, në mars të vitit 2013, përkatësisht me 10 mars 2013, me qëllim të bashkimit me organizatën “Al Nusra”, ka filluar ushtrimet ushtarake me qëllim që të kthehen në luftime në kuadër të organizatës terroriste: “Al-Nusra” e cila më vonë njihej si ISIS, e cila ishte shpallur organizatë terroriste nga OKB-ja, dhe se pas disa ditësh, përkatësisht me 23. 03. 2013, parashtruesi i kërkesës ishte kthyer në Kosovë. Në vijim aktakuza theksonte që “[...] përtej dyshimit të bazuar është vërtetuar që i pandehuri Nuredin Sylejmani, me dashje dhe me vetëdije u është bashkuar forcave ushtarake të ISIS-it. Gjithashtu i pandehuri edhe pas kthimit

nga Siria është marrë me veprimtari të kundërligjshme për çka edhe janë zhvilluar procedura tjera penale.”

30. Më 5 Gusht 2020, PSRK , ngriti Aktakuzën [PPS.nr. 01/18] kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 143 (Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist) të KPRK .
31. Më 29 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës, përmes mbrojtësit të tij, paraqiti kundërshtim [PS.nr. 33/120] ndaj provave të aktakuzës [PPS.nr. 01/18], në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe kërkoi hudhjen e aktakuzës me pretendimin se Prokuroria Speciale ka ngritur aktakuzë e cila është refuzuar me vendim të formës së prerë si dhe e njëjta ka dështuar t'a mbështesë dyshimin e bazuar me prova të pranueshme, duke theksuar se: (i) parashtruesi i kërkesës është shpallur i pafajshëm në një procedurë tjetër të zhvilluar kundër tij, për provat e përdorura në këtë gjykim; (ii) provat janë të papranueshme pasi që nuk janë siguruar në rrugë ligjore të përcaktuara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin në vijim: KPPPRK-së); (iii) dëshmitarët nuk dëshmojnë asgjë në lidhje me inkriminimin e parashtruesit të kërkesës ngase me deklaratat e tyre nuk provojnë asnjë element të veprës penale; (iv) nuk paraqet vepër penale periudha për të cilën akuzohet parashtruesi se ka qenë pjesë e organizatës “Al-Nusra”, pasi që në kohën kur dyshohet të ketë marrë pjesë parashtruesi në grupin terrorist, “Al-Nusra” nuk ka qenë organizatë terroriste.
32. Në një datë të paspecifikuar, PSRK në shqyrtimin gjyqësor e kundërshton kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin [PS.nr. 33/120] ndaj provave të aktakuzës [PPS.nr. 01/18] me arsyetimin se *“dispozitivi i aktakuzës për të cilën po zhvillohet ky gjykim, nuk bën pjesë në atë aktakuzë [PPKR. 347/13]”* dhe i propozon gjykatës që të vazhdohet me gjykimin në raport me Aktakuzën [PPS.nr. 01/18].
33. Më 3 nëntor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PS.nr.33/2020] refuzoi kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet e provave të parashtruara ndaj Aktakuzës [PPS.nr. 01/2018] të PSRK-së.
34. Me 29 qershor 2021, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale; shkelje të ligjit penal; vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike; dhe vendimit mbi dënimin e shqiptuar.
35. Më 22 janar 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.S.nr.2/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi si në vijim:

“Në pretendimin e mbrojtjes se është shkelur parimi ne bis in idem, nuk qëndron për faktin se aktakuza e ngritur tani nga Prokuroria Speciale dhe aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Prishtinë PAKR.nr. 252/15 nuk janë çështje e njëjtë penale, për faktin se përshkrimi faktik i veprës në aktakuzën e tanishme dhe përshkrimi faktik i veprës në dispozitivin e aktgjykimit të formës së prerë, dallon edhe për nga koha e kryerjes së veprës penale edhe për nga vendi i kryerjes së veprës. Përderisa me aktgjykimin e formës së prerë i akuzuari është liruar për vepra që janë pretenduar se janë kryer në korrik deri në nëntor të vitit 2013, në aktakuzën e tanishme koha e pretenduar e kryerjes së veprës penale është në mars të vitit 2013, për derisa vepra sipas aktgjykimit të formës së prerë është kryer në Republikën e Kosovës lidhur me përgatitje të sulmeve në Maqedoni dhe Kosovë, me aktakuzën e tanishme pretendimet janë se i akuzuari ka udhëtuar për

në Siri me qëllim që ti bashkangjitet organizatës terroriste Al Nusra. Andaj, pretendimet nga aktakuza e tanishme, tregojnë se kemi të bëjmë me veprime tjera, në kohë tjetër dhe vend tjetër të kryerjes së veprës penale, e jo siç pretendohet nga mbrojtja.”

36. Më 22 prill 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [PS.nr. 33/2020] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”, nga neni 143 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës [PPS .nr. 01/2018] të Prokurorisë Speciale, dhe u dënua me burgim me kohëzgjatje prej tre (3) viteve si dhe të paguajë shumën prej njëqind (100.00 euro) dhe pesëdhjetë (50.00 euro), në emër të paushallit gjyqësor.
37. Më 29 qershor 2021 dhe 30 qershor 2021, mbrojtësit e parashtruesit të kërkesës, parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar: (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) shkelje të ligjit Penal; dhe (iv) vendimit lidhur me sanksionin penal.
38. Në një datë të paspecifikuar, PSRK parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të lartë me burgim me çka do të arrihet qëllimi i dënimit.
39. Më 22 tetor 2021, Gjykata e Apelit – Departamenti Special nxori Aktgjykimin [APS.nr.27/21], me të cilin refuzoi ankesën e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, si dhe ankesën e ushtruar nga Prokuroria Speciale, duke vërtetuar Aktgjykimin [PS.nr. 33/2020] e Gjykatës Themelore të 22 prillit 2021.
40. Më 1 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës përmes mbrojtësit të tij, paraqiti kërkesë për bashkimin e dënimeve. Ai kërkoi nga Paneli i Gjykatës Themelore në Prishtinë, që në bazë të nenit 80 (Dënimin për bashkim të veprave penale) të KPRK-së, t’i shqiptohet dënim unik për veprat penale për të cilat është dënuar me Aktgjykim të formës së prerë sipas Aktgjykimit [Kp.nr. 373/2021] të 11 qershorit 2021, me të cilin është dënuar me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej pesë (5) vite dhe dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e tetëqind euro (1,800.00 Euro) si dhe për veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në organizata terroriste” nga neni 143 paragrafi 2 të KPRK-së për të cilin i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vite.
41. Më 28 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës, përmes mbrojtësit të tij, paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të: (i) shkeljes së ligjit Penal; (ii) shkeljes esenciale të Ligjit të Procedurës Penale si pasojë e të bazuarit në prova të papranueshme; dhe (iii) shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore.
42. Më 13 janar 2022, Prokurori i shtetit përmes shkresës [KMLP.II. 7/2022] propozoi që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga parashtruesit e kërkesës përmes mbrojtësit të tij.
43. Më 19 janar 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr. 9/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, të ushtruar nga i njëjti përmes mbrojtësit të tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Departamenti Special [PS.nr.33/2020] dhe të Gjykatës së Apelit - Departamenti Special [APS.nr. 27/2021].

44. Më 20 prill 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [KP.nr. 91/2022], ndryshoi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kolegjit Shqyrtues [KP.nr.373/2021] i 11 qershorit 2021 dhe Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special [PS.nr.33/2020] i 22 prillit 2021, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës dënim unik me burg në kohëzgjatje prej shtatë (7) vite e dhjete (10) muaj si dhe dënim më gjorbë në shumën prej njëmijë e tetëqind (1800.00) euro. Gjykata Themelore ndryshmin e aktgjykimeve në fjalë e kishte bazuar në “nenin 420 par. 1, 2 dhe 5 të KPPK-së i ndryshon këto aktgjykime sa i përket vendimit mbi dënimin me burg, ashtu që për të gjitha veprat penale si në pikën 1,2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe në kuptim të nenit 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

45. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në çështjet penale] dhe nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së dhe nenin 4 [E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë] të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.
46. Parashtruesi i kërkesës thekson “se shkeljet e pretenduara të lirive dhe të drejtave themelore e kanë përcjellur procesin gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit. Prandaj pretendimet në këtë kërkesë ju referohen të tri aktgjykimeve të gjykatave të rregullta”.
47. Në vijim, Gjykata do i paraqesë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në specifikat e tyre.

(I) Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

48. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e ndërton rastin e tij mbi pretendimet për shkelje të garancive procedurale të garantuara me këto nene, duke ndërlidhur pretendimet e tij me: (i) mos-arsyetim të vendimit gjyqësor si rezultat i mos-shqyrtimit të argumenteve të parashtruesit të kërkesës, si dhe administrimit të provave të papranueshme; (ii) pamundësimin e realizimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.
49. Parashtruesi i kërkesës pretendon mos-arsyetim të vendimeve gjyqësore për sa i përket mos-shqyrtimit të argumenteve kryesore me pretendimin për “arsyetime të paqarta, kontradiktore dhe me interpretim të situatave në mënyrë të shtrembëruar dhe duke mjegulluar çështjet esenciale të procesit dhe ligjit, i shmanget pretendimeve kryesore të parashtruesit të kërkesës.” Parashtruesi i kërkesës thirret në praktikën e GJEDNJ-së, duke iu referuar përkatësisht rastit *H. kundër Belgjikës* duke theksuar “Garancitë e mishëruara në nenin 6 të Konventës përfshinë obligimin e gjykatave që të japin arsyetime të mjaftueshme të vendimit të tyre”. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ankohet se vendimi përveç që është i paarsyetuar, i njëjti është edhe jologjik. Tutje, parashtruesi referohet edhe në rastet *Buzescu kundër Rumanisë* dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë* ku theksohej që “gjykatat janë të obliguara të shqyrtojnë argumentet kryesore të palës”, ku pretendon se gjykata nuk ka bërë trajtimin e pretendimeve të tij”.

50. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se përgjatë shqyrtimeve gjyqësore atij i ishte pamundësuar realizimi i *parimit të kontradiktoritetit*, për shkak të pranimit të deklaratës së dëshmitarit H.H. të dhënë si dëshmitarë në procedurë hetimore, e cila u pranua nga gjykatat e rregullta. Këtu parashtruesi thirret në cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë kur gjykata e konsideron të pranueshme deklaratën e H.H. të dhënë gjatë fazës së hetimeve e jo në seancë gjyqësore. Tutje parashtruesi thekson se: *“H.H. përpos që nuk është sjellë për të dëshmuar gjatë procesit gjyqësor, duke pamundësuar realizimin e parimit të kontradiktoritetit, rrjedhimisht duke mos qenë dëshmitar i pranueshëm edhe sipas dispozitave procedurale penale të Republikës së Kosovës, ai në kohën e mbajtjes së gjyqimit ka pasur statusin e të bashkëpandehurit. Administrimi vetëm i deklaratës së dhënë në prokurori, gjatë fazës së hetimit duhet të shpallet provë e papranueshme”*.
51. Në vijim, parashtruesi i kërkesës ankohet në përdorimin e provave, përkatësisht fotografive të sekuestruara, të cilat janë përdorur në një proces të mëparshëm gjyqësor. Sipas tij, duke u bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, është i palejueshëm përdorimi i provave nga një proces tjetër gjyqësor dhe përdorimi i tyre për të iniciuar një procedurë penale për vepër të ngjashme penale apo vepra penale të lidhura me veprën penale për të cilën është akuzuar në procedurën e parë, konsiderohet shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të garantuar nga neni 34 i Kushtetutës dhe neni 4 i Protokollit Nr. 7, të KEDNJ-së.
52. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat në vendosjen e çështjes e kanë shmangur pretendimin kryesor në lidhje me kohën e shpalljes së *“Frontit Al-Nusrah”* si organizatë terroriste. Ai ankohet se gjykatat nuk kanë specifikuar askund se nga cila datë deri në cilën parashtruesi ka qenë pjesë e organizatës Al Nusrah. Organizata në fjalë në mars të 2013-tës nuk ka qenë organizatë terroriste. Mbi bazën e faktit se kjo organizatë, e shpallur si organizatë terroriste nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, gjykata e shpallë parashtruesin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Parashtruesi pretendon se gjykatat e kanë mjegulluar faktin se periudha për të cilën akuzohet parashtruesi se ka qenë pjesë e kësaj organizate, organizata në fjalë nuk ka qenë e shpallur si organizatë terroriste. Rrjedhimisht, gjykatat kanë shpërfillur faktet e rastit të cilat të qojnë në përcaktimin e kundërligjshmërisë.

(II) Pretendimet për shkelje të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së

53. Parashtruesi i kërkesës bazohet në nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të KEDNJ-së që përcaktojnë se askush nuk mund të dënohet e të akuzohet për asnjë vepër penale e cila në momentin e kryerjes nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale. Nga të lartçekurat, parashtruesi i kërkesës në kontekst të mos përcaktimit të momentit të kundërligjshmërisë theksoi se *“gjykatat e rregullta arsyetojnë inkriminimin e parashtruesit të kërkesës, me konstatimin se organizata Al Nusrah është shpallur organizatë terroriste nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, dhe për këtë arsye parashtruesi ka qenë pjesë e një organizate terroriste.”*
54. Pra, sipas parashtruesit të kërkesës: *“nëse një organizatë për një kohë të caktuar nuk është konsideruar terroriste dhe madje është përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare, atëherë edhe sikur të ishte pjesëtar i saj për periudhën e pretenduar, parashtruesi nuk do të kishte kryer vepër penale”*.
55. Përkitazi me këtë ai i referohet praktikës së GJEDNJ-së e cila thekson se *“Një individ duhet ta ketë mundësinë për të ditur, duke u nisur nga formulimi i dispozitës*

përkatëse, e në rast nevojë, me ndihmën e interpretimit që i jepet asaj nga gjykatat dhe pasi të ketë marrë eventualisht këshilla të përshtatshme ligjore, se cilat veprime dhe mosveprime e ngarkojnë atë me përgjegjësi penale dhe çfarë mase dënimi rrezikon t'i jepet për to (Cantoni k. Francës, paragrafi 29; Kafkaris k. Qipros[DhM], paragrafi 140; Del Rio Prada k. Spanjës [DhM], paragrafi 79)”.

56. Parashtruesi i kërkesës duke iu referuar rasteve “Pessinno k. Francës, paragrafët 35-36; Dragotoni u e Militaru-Pidhorni k. Rumanisë, paragrafët 43- 47; Dallas k. Mbretërisë së Bashkuar, paragrafët 72-77”, thekson se “parashikueshmërinë e interpretimit gjyqësor e përcakton me elementet përbërëse të veprës penale dhe gjithashtu edhe me masën e zbatueshme të dënimit (Alimucaj k. Shqipërisë, paragrafët 154-162; Del Rio Prada k. Spanjës [DhM], paragrafët 111-117). Sipas parashtruesit në lidhje interpretimin e një doktrine përkatëse që shkon në të njëjtin drejtim me atë të jurisprudencës në rastet (K.A. e A.D. k. Belgjikës, § 59; Alimucaj k. Shqipërisë, paragrafët 158-160), interpretimi i lirë i një teksti ligjor nga ana e doktrinës nuk e zëvendëson ekzistencën e një jurisprudence tjetër (Dragotoni u e Militaru-Pidhorni k. Rumanisë, paragrafët 26 e 43)”.
57. Tutje parashtruesi duke iu referuar nenit 7, ankohet në zbatimin prapaveprues të së drejtës penale kur ajo është në dëm të të interesuarit (këtë rast parashtruesit). Sipas tij në rastet “Vasiliauskas k. Lituanisë, Jamil k. Francës, M. v. Gjermanisë, dhe Gurguchiani k. Spanjës, parimi i mos-ekzistencës së fuqisë prapavepruese të ligjit penal zbatohet si për dispozitat që përkufizojnë veprat penale dhe për ato që caktojnë masat e dënimit.”
58. Duke u bazuar në praktikën e lartcekur të GJEDNJ-së, të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, parashtruesi pretendon se në rastin konkret është bërë një zbatim prapaveprues i ligjit penal për arsye se në periudhën për të cilën po akuzohet se ai ka qenë pjesë e organizatës terroriste (periudhë kjo e cila nuk specifikohet nga gjykatat), organizata në fjalë (Al Nusrah) nuk ka qenë e listuar si organizatë terroriste dhe se ajo është mbështetur nga qeveritë e shteteve të ndryshme, njëjtë sikurse grupet tjera luftuese në Siri.
59. Sipas parashtruesit të kërkesës fronti *AI-Nusrah* është listuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara si organizatë terroriste me vendimin e Këshillit të Sigurimit të 30 majit 2013. Rrjedhimisht për periudhën në të cilën akuzohet parashtruesi i kërkesës, nuk bëhet fjalë për vepër penale, edhe sikur të kishte qenë pjesëmarrës në ushtrimet e organizuara nga ky front ushtarak.

(III) Pretendimet për shkelje të nenit 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së

60. Fillimisht Parashtruesi i kërkesës thekson se “Neni 34 të Kushtetutës dhe nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, parashohin se askush nuk mund të gjykohej më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.”
61. Parashtruesi i kërkesës thekson se “GJEDNJ në nenin 4 të Protokollit nr. 7, shprehimisht e përcakton si dispozitë që e ndalon ndjekjen ose gjykimin e një personi për një ‘vepër’ të dytë për sa kohë që kjo e fundit ka si zanafillë fakte të njëjta ose fakte që janë ‘në thelb’ të njëjta me ato të veprës së parë (Sergue'i Zolotoukhine k. Rusisë [DhM], paragrafët 79-82).” Sipas parashtruesit të kërkesës “nëse faktet për të dy procedimet kanë qenë të njëjta atëherë pikënisje për shqyrtimin e pyetjes duhet të jetë krahasimi i parashtrimit të fakteve, kur është në pyetje vepra për të cilën parashtruesi

ka qenë i gjykuar, me atë që ka të bëjë me veprën e dytë për të cilën ai është akuzuar në rastin konkret.”

62. Sipas parashtruesit “GJEDNJ thotë se pak rëndësi ka se cilat pjesë të këtyre akuzave të reja mbahen ose mënjahen si përfundim në procedimin e mëvonshëm sepse neni 4 i Protokollit nr. 7 shpallë një garanci kundër ndjekjeve të reja apo rrezikut për ndjekje dhe jo ndalimin e një dënimi të dytë apo një dhënie të dytë pafajësie”.
63. Parashtruesi i kërkesës thekson se “lidhur më këtë çështje se shqyrtimin duhet drejtuar tek ato fakte të cila përbëjnë një tërësi rrethanash faktike komplete në të cilin rast “del i përzier i njëjti autor e cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht në mes tyre në kohë dhe hapësirë, sepse duhet të vërtetohet ekzistenca e rrethanave në mënyrë që të jepet një dënim apo të mund të niset një ndjekje penale”.
64. Parashtruesi tutje thekson “[...] gjykatat theksojnë vet se provat (fotografitë) i kanë marrë nga gjykimi në rastin PKR.nr.252/15 dhe se nuk e konsiderojnë res judicata (çështje të gjykuar), sepse aty i njëjti është shpallur i pafajshëm për veprën penale lehtësim i pjesëmarrjes në organizata terroriste, ndërsa në këtë procedurë po akuzohet për pjesëmarrje në organizata terroriste. Sipas parashtruesit “Përpos që kjo nuk qëndron, pasi nga aktakuza e parë vërehet kjartë se ai ndër të tjera ishte akuzuar edhe për veprën pjesëmarrje në organizata terroriste, mirëpo i njëjti ishte shpallur i pafajshëm për këto vepra.”
65. Sipas parashtruesit “është e palejueshme nëse me provat [fotografitë]e njëjta nga rasti paraprak në fjalë ngritët aktakuzë e re, sepse GJEDNJ këtë e konsideron si shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së. Ai ankohet në faktin se Prokuroria nuk ka bërë rihapje të procedurës por me prova[fotografitë] të marra nga gjykimi i parë ka iniciuar procedurë të re për vepër penale për të cilën ai veçse është gjykuar. Ecuria procedurale e tillë sipas parashtruesit të kërkesës ka konfirmuar se gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ato që burojnë nga Konventa”.
66. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të (I) shpallë kërkesën të pranueshme; (II) Konstaton shkeljen e lirive dhe të drejtave themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 33 të Kushtetutës [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së dhe nenin 34 të Kushtetutës [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së; (III) T’i shpallë të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Themelore PS nr. 33/2020, aktgjykimet të Gjykatës së Apelit të Kosovës APS nr. 27/21 dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.9/2022; (IV) T’ia kthejë Gjykatës Themelore në Prishtinë rastin për rivendosje.
67. Lidhur me kërkesën për mos zbulim të identitetit parashtruesi i kërkesës thekson “Për shkak të llojit të veprës penale për të cilën është dënuar parashtruesi i kërkesës do të paraqiste vështirësi risocializimi i tij në të ardhmen nëse identiteti i tij publikohet. Prandaj, Gjykatës i kërkojmë që të vlerësojë situatën për të ardhmen e parashtruesit dhe familjes së tij, pasi parashtruesi i kërkesës është mbajtës i familjes dhe vështirësitë në risocializimin e tij pas përfundimit të procedurave do të vështirësonin edhe ekzistencën e familjes, e cila që tani është e rënduar për shkak të burgimit që disa vite të parashtruesit.”

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.
2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.
3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.
4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

Neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]

Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NENI 6

E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale

në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

NENI 7 **Nuk ka dënim pa ligj**

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

Protokolli Nr. 7 i KEDNJ-së

NENI 4 **E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë**

1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte

të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.

3. Asnjë deroqim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

Neni 3

Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe in dubio pro reo

1. Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.

2. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 7

Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve

1. Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.

2. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Neni 111

Pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit

1. Provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse:

1.1. provat e marra gjatë kontrollit, pa lejen e gjykatës, janë të pa pranueshme, nëse kontrollimi nuk merr aprovim retroaktiv gjyqësor, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës;

1.2. kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit kompetent në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;

1.3. urdhri i gjyqtarit kompetent është lëshuar në kundërshtim me procedurën e paraparë me këtë Kod;

1.4. përmbajtja e urdhrin të gjyqtarit kompetent është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë Kod; 50

1.5. kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit kompetent;

1.6. personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit; ose

1.7. kontrolli është zbatuar në kundërshtim me nenin 108 të këtij Kodi

Neni 403
Ndryshimi i aktgjykimit të gjykatës themelore

1. Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore me aktgjykim kur vërteton se gjykata themelore ka bërë vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve, dhe për këtë qëllim:

1.2. mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

68. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

69. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës të cilët përcaktojnë se:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

70. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

71. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml.nr.9/2022] e 19 janarit 2022, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
72. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në këtë aspekt, Gjykata do t'u referohet rregullave relevante të Rregullores së punës, si në vijim:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimin ose vendimit të kontestuar.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

73. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me akuzat ndaj parashtruesit të kërkesës [dhe tre personave të tjerë] nga PSRK-ja për pjesëmarrje në kuadër të grupit terrorist "Al Nusra" në periudhën 10 -23 mars 2013, me ç' rast u akuzua për kryerjen e veprës penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist bazuar paragrafin 2 të nenit 143 (Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi nr. 04/L-082 (në tekstin në vijim: KPRK). Gjykata Themelore e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste" dhe e dënoi me burgim me kohëzgjatje prej tre (3) viteve si dhe të paguajë shumën prej njëqind (100.00 euro) dhe pesëdhjetë (50.00 euro), në emër të paushallit gjyqësor. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe PSRK-së, Gjykata e Apelit refuzoi ankesat dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Përfundimisht, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar Gjykata Supreme. Bazuar në kërkesën e parashtruesit të datës 1 dhjetor 2021, për bashkimin e dënimeve, më 20 prill 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimin [KP.nr. 91/2022], ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kolegjit Shqyrtues [KP.nr.373/2021] të 11 qershorit 2021 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special [PS.nr.33/2020] të 22 prillit 2021, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës dënim unik me burg në kohëzgjatje prej shtatë (7) vite e dhjete (10) muaj si dhe dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e tetëqind (1800.00) euro.

74. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta, duke ngritur: (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, duke pretenduar shkelje të garancive procedurale të garantuara me këto nene, duke theksuar: (i) *mos-arsyetim të vendimit gjyqësor* si rezultat i mos-shqyrtimit të argumenteve të parashtruesit të kërkesës, si dhe administrimit të provave të papranueshme; (ii) shkelje të parimit të *kontradiktoritetit* dhe *barazisë së armëve*, (II) shkelje të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, si rezultat i mos-përcaktimit të momentit të kundërligjshmërisë; dhe pretendimet për (III) shkelje të nenit 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.
75. Në trajtimin e pretendimeve të lartcekura të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të aplikojë praktikën e saj dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
76. Në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, në kontekst të konstatimit nëse janë shteruar mjetet juridike në aspektin formal dhe substancial siç është përcaktuar në rregullin 39 (1) (b) të lartcekur të Rregullores së punës, Gjykata fillimisht do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 34 të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 të Protokollit Nr.7 të KEDNJ-së, ndërsa më pas, do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe pretendimin për shkelje të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, lidhur me mos-përcaktimin e momentit të kundërligjshmërisë, bazuar në përcaktimin e rregullit 39 (2) të Rregullore së Punës.
- (I) Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së**
77. Gjykata fillimisht rikujton pretendimet e parashtruesit të kërkesës që përmes Vendimit të kontestuar, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së. Në mbështetje të pretendimit për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 34 të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 të Protokollit Nr.7 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson *“nga aktakuza e parë vërehet kjartë se ai ndër të tjera ishte akuzuar edhe për veprën pjesëmarrje në organizata terroriste, mirëpo i njëjti ishte shpallur i pafajshëm për këto vepra.”*
78. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës kishte dorëzuar në Gjykatën Supreme *kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë* kundër Aktgjykimit [P.S.nr.33/20] të 22 prillit 2021, të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, bazuar në shkresat e lëndës nuk rezulton që pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 34 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 4 të Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së, të jenë ngritur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar në Gjykatën Supreme.

79. Më saktësisht, Gjykata vëren se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte ngritur “konform nenit 432 të KPK: 1.1 për shkak të shkeljes së ligjit penal; 1.2 për shkelje esenciale të ligjit të Procedurës Penale, nga neni 384 par. 1.8 aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme, dhe 1.3 në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale, kur këto shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimeve të atakuara”.
80. Në një kontekst të tillë, kur pretendimet e parashtruesit të kërkesës as formalisht por as në substancë/përmbajtje nuk janë ngritur para gjykatave të rregullta, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial, dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta, ndër të tjera, edhe në rastet e Gjykatës, KI40/20, parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 shkurtit 2021 (paragrafi 66); KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2009 (paragrafi 71), KI154/17 dhe KIO5/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019 (paragrafi 92), KI155/18, parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019 (paragrafi 50) e KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020 (paragrafi 59).
81. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ndërthet në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet. (Shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, KI71/18, parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73; rastin KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 94; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 61).
82. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë. (Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 2478/15 dhe 1787/15, Vendim i 23 qershorit 2015, paragrafi 90; *Azinas kundër Qipros*, kërkesa nr. 56679/00, Aktgjykim i 28 prillit 2004, paragrafi 38; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 93; rastin KI155/18, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 60).

83. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 34 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 4 të Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së, janë ngritur para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 95; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 62).
84. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo të korrigjohen shkeljet e tilla pasi ato të kenë ndodhur. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë mundësitë në procedurat pranë gjykatave të rregullta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI24/16, me parashtrues *Audi Haziri*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39 dhe referencat e përmendura aty; si dhe rastin KI01/19, me parashtrues *Fatos Rizvanolli*, Aktvendim për Papranueshmëri i 1 tetorit 2020, paragrafi 99).
85. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 34 të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 të Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së, refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
- (II) Përkritazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së**
86. Fillimisht, Gjykata rikujton që pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkritazi me shkelje të drejtave dhe lirive individuale të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndërlidhen me: (i) *mos-arsyetim të vendimit gjyqësor* si rezultat i mos-shqyrtimit të argumenteve të parashtruesit të kërkesës, si dhe administrimit të provave të papranueshme; (ii) pamundësimin e realizimit të parimit të *kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*.
87. Gjithashtu, Gjykata rikujton se në mbështetje të pretendimit për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës në kontekst të mos përcaktimit të momentit të kundërligjshmërisë theksoi se *“gjykatat e rregullta arsyetojnë inkriminimin e parashtruesit të kërkesës, me konstatimin se organizata Al Nusrâh është shpallur organizatë terroriste nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, dhe për këtë arsye parashtruesi ka qenë pjesë e një organizate terroriste.”* Rrjedhimisht sipas parashtruesit të kërkesës *“në rastin konkret është bërë një zbatim prapaveprues i ligjit penal për arsyen se në periudhën për të cilën po akuzohet se ai ka qenë pjesë e organizatës terroriste (periudhë kjo e cila nuk specifikohet nga gjykatat), organizata në fjalë (Al Nusrâh) nuk ka qenë e listuar si organizatë terroriste.”*

88. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*”.
89. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
90. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me shpalljen fajtor të parashtruesit të kërkesës nga ana e Gjykatës Themelore, për veprën penale “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste*” ku u dënua me burgim me kohëzgjatje prej tre (3) viteve. Ankesat e parashtruesit të kërkesës [lidhur me (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) shkelje të ligjit Penal; dhe (iv) vendimit lidhur me sanksionin penal] dhe Prokurorisë për shkak të vendimit mbi dënim, i refuzoi Gjykata e Apelit, duke e vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në vijim kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar Gjykata Supreme.
91. Bazuar në pretendimet e parashtruesit, Gjykata në vijim sqaron që pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] për sa i përket *mos-përcaktimit* të momentit të kundërligjshmërisë, në thelb ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Rrjedhimisht, Gjykata do i shqyrtojë këto pretendime si të ndërlidhura.
92. Në vijim, Gjykata do t’i shqyrtojë fillimisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkelje të: (i) nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me *mos-arsyetim të vendimit gjyqësor* si rezultat i mos-shqyrtimit të argumenteve të parashtruesit të kërkesës, si dhe administrimit të provave të papranueshme, në ndërlidhje me pretendimin për shkelje të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, për sa i përket *mos-përcaktimit* e momentit të kundërligjshmërisë; si dhe (ii) pretendimin për pamundësimin e realizimit të parimit të *kontradiktoritetit* dhe *barazisë së armëve*.
93. Në vijim Gjykata do të elaborojë parimet e përgjithshme lidhur me (i) arsyetimin e vendimit gjyqësor; (ii) parimin: “*Nuk ka dënim pa ligj: parimin që vetëm ligji mund ta përcaktojë një veprë penale dhe të përcaktojë një dënim*” të Nenit 7 të KEDNJ-së; dhe do t’i aplikoj të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore

94. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo

tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

95. Në parim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsytet në të cilat ato bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të mbështetura në ligjin e aplikueshëm (Shih rastin e Gjykatës KI97, me parashtrues *IKK Classic*, cituar më lartë, paragrafi 45; Shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).
96. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
97. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës

së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

98. Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me: (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28); ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96 dhe referencat në të; dhe gjithashtu shih rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T. "Spahia Petrol"*, cituar më lart, paragrafi 48).

(ii) Parimi: "Nuk ka dënim pa ligj: parimin që vetëm ligji mund ta përcaktojë një vepër penale dhe të përcaktojë një dënim" të Nenit 7 të KEDNJ-së;

99. Neni 7 zbatohet vetëm kur personi është "shpallur fajtor" për kryerjen e një vepre penale. Për qëllimet e Konventës, nuk mund të ketë "dënim" nëse nuk është vërtetuar në përputhje me ligjin se ka pasur një vepër penale (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Varvara kundër Italisë*, nr. 17475/09, Aktgjykim i 29 tetorit 2013, paragrafi 69).
100. Garancia e parashikuar në nenin 7 të KEDNJ-së, e cila është një element thelbësor i shtetit të së drejtës, zë një vend të spikatur në sistemin e mbrojtjes së Konventës. Ky nen interpretohet dhe zbatohet nga objekti dhe qëllimi i tij, në mënyrë të tillë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes penale arbitrare, shpalljes fajtor dhe dënimit (shih rastet e GJEDNJ-së: *S.W. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 20166/92, Aktgjykim i 22 nëntorit 1995, paragrafi 34; *C.R. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 20166/92, Aktgjykim i 22 nëntorit 1995, paragrafi 32; *Del Río Prada kundër Spanjës* [GC], nr. 42750/09, Aktgjykim i 21 tetorit 2013, paragrafi 77; *Vasiliauskas kundër Lituanisë*, nr. 35343/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2015, paragrafi 153).
101. Neni 7 i Konventës kërkon ekzistencën e një baze ligjore për të shqiptuar një masë ose një dënim. Prandaj, gjykata duhet të verifikojë se në kohën kur një i akuzuar ka kryer veprën që ka çuar në ndjekjen dhe dënimin e tij, ka ekzistuar një dispozitë ligjore që e bën atë akt të dënueshëm dhe se dënimi i shqiptuar nuk i ka kaluar kufijtë e përcaktuar me atë dispozitë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Coëme dhe të tjerët kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 22 qershorit 2020, paragrafi 145; *Del Río Prada kundër Spanjës*, cituar më lartë, paragrafi 80).
102. Duke pasur parasysh natyrën dytësore të sistemit të Konventës, nuk është funksioni i GJEDNJ-së të trajtojë gabimet e faktit ose ligjit të supozuar të kryera nga një gjykatë kombëtare, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa (shih rastet e GJEDNJ-së: *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2001, paragrafi 49; *Vasiliauskas kundër Lituanisë*, cituar më lartë, paragrafi 160), dhe përveç nëse vlerësimi i kryer nga gjykatat vendase është haptazi arbitrar (shih rastin e GJEDNJ-së: *Kononov kundër Letonisë*, nr. 36376/04, Aktgjykim i 17 majit 2010, paragrafi 189).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

103. Fillimisht, Gjykata sqaron se do të shtjellojë nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, ndërlidhur me pretendimin për sa i përket mos-përcaktimit e momentit të kundërligjshmërisë, se a është në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, lidhur me nenin 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së.
104. Pra, në vijim gjykata do të shqyrtojë së bashku pretendimet për mos-arsyetim të vendimit gjyqësor, si dhe mos përcaktimin e momentit të kundërligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës.
105. Gjykata rikujton se në Aktgjykimin [APS.nr.27/21] e 22 tetorit 2021, të Gjykatës së Apelit, e njëjta kishte trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar si në vijim:

“Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Nuredin Sylejmani në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga prova e administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë: Raporti i Sistemit për Menaxhimin e Kufirit i datës 9 shkurt 2018, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari Nuredin Sylejmani se bashku me H. H., janë kthyer nga Republika e Turqisë, me datë 23 mars 2013, deklarata e dëshmitarit H.S. e dhëne si dëshmitarë në procedurë hetimore, nga dëshmia e dëshmitareve A.I. dhe S.S., nga fotot të cilat janë pjesë e Memorandumit Zyrtar të Policisë së Kosovës nën numrin DKT/I/D/076/2019 të datës 2 mars 2018, nga Memorandumi Zyrtar i Policisë së Kosovës nën numrin 2018-DKT-1 i datës 2 mars 2018, respektivisht fotot e bashkangjitura në këtë memorandum, nga tele-komunikimet e të akuzuarit, të cilat tele-komunikime ndërlidhen me këtë veprë penale, nga memorandum i Policisë së Kosovës në numrin DKT/I/D-076/2019 i datës 2 mars 2018, potencon komunikimet e të akuzuarit Nuredin Sylejmani me personin L.M , në bazë të të cilëve ka konstatuar se i akuzuari nga data 10 mars 2013 e deri më datë 23 mars 2013 me dashje i është bashkangjitur organizatës terroriste “Al Nusra”, në Siri së bashku me të bashkëpandehurin H.H, ashtu që me datë 10 mars 2013 nga Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë ka udhëtuar për në Stamboll, pastaj nga Stambolli ka udhëtuar me aeroplan për në Aeroportin e Hatait, ndërsa nga Hatai ka me taksi ka udhëtuar për në Rajhall, për të përfunduar në fund në Idlib, ku janë takuar me shqiptarë të tjerë, kanë filluar trajnimet ushtarake me qëllim të pjesëmarrjes në luftimet e organizatës terroriste “AI Nusra”, e njohur më vonë si “ISIS”, e cila organizatë nga OKB është shpallur si organizatë terroriste ku me datë 23 mars 2013 kthehet në Kosovë.

Lidhur me deklaratën e këtij dëshmitari gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete se gjykata ka administruar deklaratën e tij si provë, e cila është dhënë në fazën hetimore, dhe se dëshmitari H. H., nuk ka qenë i bashkëpandehur në kohën kur ai e ka dhënë deklaratën e tij para organeve të ndjekjes penale, ai këtë deklaratë e ka dhënë në cilësi të dëshmitarit e ku më vonë për të kanë filluar hetimet dhe i njëjti ka fituar cilësinë e të pandehurit, ndërsa deklaratën e këtij dëshmitari më vonë të marrë në cilësi të të pandehurit nuk e ka administruar në raport me të akuzuarin Nuredin Sylejmani dhe se deklarata e tij nuk është provë e vetme mbi të cilën gjykata ka vërtetuar fajësinë e të akuzuarit Nuredin ashtu siç pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarit.

Sa i përket deklaratave të dëshmitareve A.I. dhe S.S., të cilat deklarata sipas mbrojtëseve nuk vërtetojnë asgjë pasi që të dy deklarojnë se nuk e njohin të

akuzuarin dhe nuk e kanë takuar asnjëherë, mirëpo sa i përket këtyre dëshmitarëve gjykata e shkallës së parë në kontekst të deklarimit të tyre ka vërtetuar faktin se si të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët kanë marrë pjesë në luftën e Sirisë, përkrah organizatave terroriste, kanë ndjekur të njëjtën rrugë të udhëtimit, rekrutimit dhe marrjes pjesë në luftime.

106. Mbi këtë vijë argumentimi, Gjykata vë theksin edhe në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, më të cilin u refuzua kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, si në vijim:

“Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet tjera nga kërkesa si dhe duka u bazuar në shkresat e çështjes gjen se qëndron fakti se dëshmitari H. H. është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit dhe të pandehurit por aktgjykimi është bazuar në deklaratën e tij të dhënë me datën 16 janar 2018 në cilësi të dëshmitarit dhe i njëjti në kohën kur e ka dhënë këtë deklaratë nuk ka qenë i bashkëpandehur ma të dënuarin Nuredin. Vetëm më vonë kanë filluar hetimet për të njëjtin. Me të drejtë në aktgjykimin e shkallës së parë, i cili është vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, potencohet se bazuar në nenin 123 par.5 të KPPK, përjashtohet mundësia që i bashkëpandehuri të jap deklaratë në cilësi të dëshmitarit, ndërsa në bazë të nenit 126 par.1 nënpar. 1.3 të KPPK si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedura e përbashkët. Për më tepër kjo nuk ishte prova e vetme në të citën është bazuar aktgjykimi, ndërsa nga deklaratat e tij vërtetohet se i dënuari së bashku me të kishte shkuar në Siri (në kufirin turko-sirian) që fillimisht në kamp ushtarak të përgatiten për luftë me pas e më pas të kthehen dhe të marrin pjesë në luftime. Pra i dënuari me vetëdije të plotë dhe me vullnetin e tij ka shkuar në Siri, nëpërmjet Turqisë, së pari duke iu bashkangjitur ushtarëve të cilët në kampe ushtarake përgatiteshin për luftë e me qëllimin përfundimtar që t'i bashkohet në luftime në Siri, organizatës "AL Nusra", e cila në atë kohë vepronte në kuadër të "Al Qaidas" - Organizatë kjo terroriste e shpallur nga OKB.”

“[...] kjo Gjykatë gjen se i dënuari Nuredin Sylejmani pasiqë paraprakisht kishte komunikuar me personin L.M., i cili siç u cek më lartë ishte i njohur për veprimtarinë e tij terroriste, nisat për në Siri dhe pasi që arrin në vendin Idlib, takohet edhe me shqiptarë tjerë të cilët ishin të vendosur në kampe ushtarake dhe filluan përgatitjet ushtarake për t'iu bashkuar grupeve terroriste që luftonin nën ombrellën e "Al Nusra" e cila ishte pjesë e organizatës "Ala Qaida"-organizatë kjo terroriste e shpallur nga OKB vite më parë. Pra, i dënuari ka qenë i përfshirë me vetëdije dhe me vetëdëshirë, pra ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për veprimtarinë terroriste, e për më tepër i dënuari edhe më vonë pasiqë që është kthyer nga Siria ka marrë pjesën në veprimtari e cila ka qenë e ndërlidhur me organizata terroriste. Nga të gjitha këto vërtetohet se në veprimet e të dënuarit formohen elementet qenësore, të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par.2. të KPK për të cilën është shpallur fajtor e duke u nisur nga fakti se i dënuari me dashje është bërë anëtar i grupit terrorist "Al Nusra"- e cila ishte pjesë e organizatës "Al Qaeida" organizatë kjo terroriste shpallur nga OKB, pra me nenin 143 par.2 të KPK inkriminohet pjesëmarrja në këto grupe terroriste dhe nuk duhet që të ndërmarr ndonjë veprimtari konkrete në drejtim të kryerjes së veprimtarisë terroriste.”

107. Për sa më sipër, Gjykata vë në pah se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk nënkupton një përgjigje të hollësishme për çdo pretendim dhe argument të palëve (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Hollandës*, kërkesa nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 Prillit 1994, paragrafi

61; *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], cituar më lartë, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, kërkesa nr. 40490/98, Vendim për paraneshmëri i 29 gushtit 2000; *Perez kundër Francës* [DHM], kërkesa nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81). Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata Kushtetuese (Shih rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 49).

108. Në kontekst të respektimit të garancive procedurale të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në përgjithësi, dhe Gjykata Supreme në veçanti kishin dhënë arsye të elaboruar për sa i përket bazës ligjore të kryerjes së veprës penale, nga parashtruesi i kërkesës për sa i përket përcaktimit të momentit të kundërligjshmërisë. Gjykata Supreme qartazi kishte potencuar që parashtruesi i kërkesës me vullnet të lirë ka udhëtuar në Siri për tu bashkuar radhëve të organizatës “*Al Nusra*” e cila vepronte nën ombrellën e organizatës “*Al Qaida*” e shpallur si organizatë terroriste nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Rrjedhimisht, gjykatat e rregullta kanë arsyetuar që në kohën kur parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën që ka çuar në ndjekjen dhe dënimin e tij, ka ekzistuar dispozita ligjore që e bën atë akt të dënueshëm. Pra, gjykatat e rregullta vërtetuan se në veprimet e parashtruesit të kërkesës formësohen elementet qenësore të veprës penale “*organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste*” e përcaktuar në nenin 143 paragrafi 2 të Kodit Penal, për të cilën ishte shpallur fajtor.
109. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor përkitazi me kërkesat dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Për rrjedhojë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka përfituar nga e drejta për të pranuar vendim të arsyetuar gjyqësor, në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata gjithashtu vlerëson se gjykatat e rregullta e kanë qartësuar momentin e kundërligjshmërisë të veprimeve të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, ndaj të njëjtit janë përmbushur garancitë procedurale të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së.
110. Në lidhje me këtë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë qëndrimin e përgjithshëm parimor se “*drejtësia*” që garantohet përmes nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik dhe në parim, kjo drejtësi procedurale shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KI131/19, parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55). Kjo më saktësisht nënkupton se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet: (i) t’u mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit procedural; (ii) t’u ofrohet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) t’u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) t’u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) t’u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe rastin e Gjykatës, KI131/19, cituar më lart, paragrafi 58).
111. Gjykata arrin në përfundim se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se standardet dhe garancitë e mësipërme të nenit 31 të Kushtetutës, në

lidhje me nenin 33 të Kushtetutës, nuk janë zbatuar. Parashtruesit e kërkesës edhe më tej mund të mos jenë të kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tyre, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e te drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetute (shih, rastin e GJEDNJ-së: *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

112. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendim i parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e nenin 31 për mos-arsyetim të vendimit gjyqësor, si dhe nenit 33 të Kushtetutës, për mos përcaktim të momentit të kundërligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, prandaj kjo pjesë e kërkesës duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

(ii) Përkitazi me pretendimin për shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procedurë

113. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar i është pamundësuar realizimi i parimit të *kontradiktoritetit* dhe *barazisë së armëve*. Përkitazi me këtë pretendim parashtruesi i kërkesës i referohet pranimit të deklaratës së dëshmitarit H.H. me ç' rast thekson se: "*H.H. përpos që nuk është sjellë për të dëshmuar gjatë procesit gjyqësor, duke pamundësuar realizimin e parimit të kontradiktoritetit, rrjedhimisht duke mos qenë dëshmitar i pranueshëm edhe sipas dispozitave procedurale penale të Republikës së Kosovës, ai në kohën e mbajtjes së gjykimit ka pasur statusin e të bashkëpandehurit. Administrimi vetëm i deklaratës së dhënë në prokurori, gjatë fazës së hetimit duhet të shpallet provë e papranueshme*".
114. Rrjedhimisht, në dritën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve.

Parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve

115. Gjykata fillimisht thekson se gjykimi i drejtë përfshin të drejtën për gjykimin në pajtim me "*parimin e kontradiktoritetit*", parim i cili është i ndërlidhur me parimin e "*barazisë së armëve*" (shih rastin e GJEDNJ-së: *Regner kundër Republikës Çeke*, nr. 35289/11, Aktgjykim i vitit 2017, paragrafi 146). Në këtë kontekst, në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm, veçanërisht në lidhje me rëndësinë që i kushtohet paraqitjeve dhe rritjes së vëmendjes apo ndjeshmërisë së publikut ndaj administrimit të drejtë të drejtësisë (shih rastin *Borgers kundër Belgjikës*, nr. 12005/86, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 24).
116. E drejta për procedurë kontradiktore nënkupton në parim mundësinë që palët në një gjykim penal ose civil të kenë njohuri dhe të komentojnë të gjitha provat e paraqitura ose vëzhgimet e paraqitura, madje edhe nga një anëtar i pavarur i shërbimit ligjor kombëtar, me synimin për të ndikuar në vendimin e gjykatës (shih rastet e GJEDNJ-së: *Kress kundër Francës*, nr. 39594/98, Aktgjykim i 7 qershorit 2001, paragrafi 74; *Ruiz-Mateos kundër Spanjës*, nr. 12952/87, Aktgjykim i 23 qershorit 1993, paragrafi 63; *McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 16424/90, Aktgjykim i 24 shkurtit 1995, paragrafi 80; *Vermeulen kundër Belgjikës*, nr. 19075/91, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996, paragrafi 33; *Lobo Machado kundër Portugalisë*, nr. 15764/89, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996, paragrafi 31). Kjo kërkesë mund të zbatohet gjithashtu edhe përpara një

Gjykate Kushtetuese (shih rastin e GJEDNJ-së: *Milatová dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 61811/00, Aktgjykim i 21 qershorit 2005, paragrafët 63-66; *Gaspari kundër Sllovenisë*, nr. 21055/03, Aktgjykim i 21 qershorit 2009, paragrafi 53).

117. E drejta për procedurë kontradiktore duhet të jetë në gjendje të ushtrohet në kushte të kënaqshme: një palë në procedurë duhet të ketë mundësinë të njihet me provat para gjykatës, si dhe mundësinë për të komentuar ekzistencën, përmbajtjen dhe vërtetësinë e tyre në një formën e duhur dhe brenda një kohe të përshtatshme (shih rastet e GJEDNJ-së: *Krčmář dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 35376/97, Aktgjykim i 3 marsit 2000, paragrafi 42; *Immeubles Groupe Kossier kundër Francës*, nr. 38748/97, Aktgjykim i 21 marsit 2002, paragrafi 26), nëse është e nevojshme duke marrë një shtyrje (shih rastin e GJEDNJ-së: *Yvon kundër Francës*, nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 prillit 2003, paragrafi 39).
118. Vetë gjykata duhet të respektojë parimin e kontradiktoritetit, për shembull nëse vendos një çështje në bazë të një arsyeje ose kundërshtimi që ajo e ka ngritur me mocionin e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Čepeck kundër Republikës Çeke*, nr. 9815/10, Aktgjykim i 5 shtatorit 2013, paragrafi 45, dhe krahasoni *Clinique des Acacias dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 65399/01, 65406/01, 65405/01 dhe 65407/01, Aktgjykim i 13 tetorit 2005, paragrafi 38, me *Andret dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 1956/02, Vendim i 25 majit 2004; në këtë rast, Gjykata e Kasacionit informoi palët se ishin parashikuar arsye të reja dhe ankuesit kishin një mundësia për t'u përgjigjur para se të jepte vendimin Gjykata e Kasacionit).
119. Gjithashtu, GJEDNJ potencoi se e drejta për procedim kontradiktor nuk është absolute dhe qëllimi i saj mund të ndryshojë në varësi të veçorive specifike të çështjes në fjalë (shih rastin e GJEDNJ-së: *Hudáková dhe të tjerët kundër Sllovakisë*, nr. 23083/05, Aktgjykim i 27 prillit 2010, paragrafët 26-27), duke iu nënshtruar shqyrtimit të Gjykatës së instancës së fundit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Regner kundër Republikës Çeke* cituar më lartë, paragrafët 146-147). Në çështjen e përmendur së fundit, GJEDNJ-ja vuri në dukje se procedurat duhej të konsideroheshin si tërësi dhe se çdo kufizim mbi parimet e kundërshtarit dhe të barazisë së armëve mund të ishte kundërbalancuar mjaftueshëm nga masa të tjera mbrojtëse procedurale (paragrafët 151-161).

Zbatimi i këtyre parimeve në rastin e parashtruesit të kërkesës

120. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës lidhur me shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, i ndërlidh me pretendimin e pranimit të deklaratës së dëshmitarit H.H., nga gjykatat e rregullta i cili e kishte edhe statusin e të bashkëpandehurit.
121. Në përcaktimin e peshës së dëshmisë së dhënë nga dëshmitari H.H dhe në veçanti, nëse provat e dhëna prej tij ishin baza e vetme ose vendimtare për dënimin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata në radhë të parë ka parasysh vlerësimin e dhënë nga gjykatat e rregullta. Prandaj, lidhur me pretendimin e parashtruesit për pamundësinë e ballafaqimit të dëshmitarit H.H. si dhe të marrjes së dëshmisë së tij edhe përkundër që kishte statusin e të bashkëpandehurit, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS.nr.27/21] të 22 tetorit 2021, theksoi si në vijim:

Lidhur me deklaratën e këtij dëshmitari gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete se gjykata ka administruar deklaratën e tij si provë, e cila është dhënë në fazën hetimore, dhe se dëshmitari H. H., nuk ka qenë i bashkëpandehur në kohën kur ai e ka dhënë deklaratën e tij para organeve të ndjekjes penale, ai këtë deklaratë e ka dhënë në cilësi të dëshmitarit e ku më vonë

për të kanë filluar hetimet dhe i njëjti ka fituar cilësinë e të pandehurit, ndërsa deklarimin e këtij dëshmitari më vonë të marrë në cilësi të të pandehurit nuk e ka administruar në raport me të akuzuarin Nuredin Sylejmani dhe se deklarata e tij nuk është provë e vetme mbi të cilën gjykata ka vërtetuar fajësinë e të akuzuarit Nuredin ashtu siç pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarit.

122. Mbi këtë vijë argumentimi, Gjykata vë theksin edhe në arsyetimin e Aktgjykimit [Prl.nr.9/2022] të 19 janarit 2022, të Gjykatës Supreme, më të cilin u refuzua kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, si në vijim:

"Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet tjera nga kërkesa si dhe duka u bazuar në shkresat e çështjes gjen se qëndron fakti se dëshmitari H. H. është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit dhe të pandehurit por aktgjykimi është bazuar në deklaratën e tij të dhënë me datën 16 janar 2018 në cilësi të dëshmitarit dhe i njëjti në kohën kur e ka dhënë këtë deklaratë nuk ka qenë i bashkëpandehur ma të dënuarin Nuredin. Vetëm më vonë kanë filluar hetimet për të njëjtin. Me të drejtë në aktgjykimin e shkallës së parë, i cili është vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, potencohet se bazuar në nenin 123 par.5 të KPPK, përjashtohet mundësia që i bashkëpandehuri të jap deklaratë në cilësi të dëshmitarit, ndërsa në bazë të nenit 126 par.1 nënpar. 1.3 të KPPK si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedura e përbashkët. Për më tepër kjo nuk ishte prova e vetme në të cilën është bazuar aktgjykimi, ndërsa nga deklarata e tij vërtetohet se i dënuari së bashku me të kishte shkuar në Siri (në kufirin turko-sirian) që fillimisht në kamp ushtarak të përgatiten për luftë me pas e më pas të kthehen dhe të marrin pjesë në luftime. Pra i dënuari me vetëdije të plotë dhe me vullnetin e tij ka shkuar në Siri, nëpërmjet Turqisë, së pari duke iu bashkangjitur ushtarëve të cilët në kampe ushtarake përgatiteshin për luftë e me qëllimin përfundimtar që t'i bashkohet në luftime në Siri, organizatës "AL Nusra", e cila në atë kohë vepronte në kuadër të "Al Qaidas" - Organizatë kjo terroriste e shpallur nga OKB."

123. Gjykata rikujton që në bazë të praktikës së GJEDNJ-së, gjykatat e rregullta e vlerësojnë nëse është e përshtatshme të thërrasin dëshmitarë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Vidal kundër Belgjikës*, aktgjykimi i 22 prillit 1992, paragrafi 33). Prandaj, nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës në cilësi të të pandehurit të ankohet se nuk i është lejuar të marrë në pyetje dëshmitarët; përveç kësaj, ai duhet të mbështesë kërkesën e tij duke shpjeguar pse është e rëndësishme që dëshmitarët në fjalë të dëgjohen dhe provat e tyre duhet të jenë të nevojshme për vërtetimin e së vërtetës (shih rastet e GJEDNJ-së: *Borisova kundër Bullgarisë*, nr. 56891/00, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2006, paragrafi 46; *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, aktgjykimi i 8 qershorit 1976, paragrafi 91; *Bricmont kundër Belgjikës*, vendimi i 7 korrikut 1989, paragrafi 29).
124. Në këtë kontekst, duke qenë se nuk i takon Gjykatës Kushtetuese të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, pikënisja e saj për përcaktimin e rëndësisë së deklaratës së dëshmitarit për dënimin e parashtruesit të kërkesës është vendimi i gjykatave të rregullta. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vendos theksin në shqyrtimin e vlerësimit të gjykatave të rregullta në dritën e standardeve të saj për vlerësimin e rëndësisë së deklaratës së dëshmitarit si provë dhe të vendosurit nëse vlerësimi i peshës së provave nga gjykatat e rregullta ishte i papranueshëm ose arbitrar. Më tej, sipas praktikës së GJEDNJ-së, Gjykata duhet të bëjë vlerësimin e vet për peshën e provave të dhëna nga një dëshmitar që mungon nëse gjykatat e rregullta nuk kanë treguar qëndrimin e tyre për atë çështje ose nëse pozicioni i tyre nuk është i qartë (shih rastin e

GJEDNJ-së: *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, nr. 9154/10, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2015, paragrafi 124).

125. Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me *'pranimin e deklaratës së dëshmitarit H.H. i cili e kishte edhe statusin e të bashkëpandehurit'* është e pabazuar pasi që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kishin theksuar qartazi që deklarata e dëshmitarit H.H. e administruar si provë, ishte dhënë në fazën e zhvillimit të hetimeve, dhe se i njëjti nuk ishte i bashkëpandehur në kohën e dhënies së dëshmisë së administruar. Ndërsa gjykatat e rregullta kishin dhënë sqarime që deklarimet e mëvonshme të H.H. në momentin kur i njëjti e kishte fituar cilësinë e të pandehurit nuk janë administruar në raport me parashtruesin e kërkesës. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin sqaruar që deklarata e dëshmitarit H.H. nuk ishte provë e vetme dhe vendimtare mbi të cilën ato kishin vërtetuar fajësinë e parashtruesit të kërkesës.
126. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës lidhur me shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, prandaj kjo pjesë e kërkesës duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

Përfundim

127. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse (I) pretendimet për shkelje të nenit 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, refuzohet si e papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. (II) pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në rastet Penale] të Kushtetutës dhe nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së; për sa i përket pretendimit për: (i) *Vendim të paarsyetuar gjyqësor* në ndërlidhje me *mos përcaktim të momentit të kundërligjshmërisë* të parashtruesit të kërkesës, shpallet i papranueshëm si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës; si dhe (ii) pretendimi për shkelje të parimit të *kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, shpallet i papranueshëm si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për mos zbulim te identitetit

128. Lidhur me kërkesën për mos zbulim te identitetit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka arsyetuar *"Për shkak të llojit të veprës penale për të cilën është dënuar parashtruesi i kërkesës do të paraqiste vështirësi risocializimi i tij në të ardhmen nëse identiteti i tij publikohet. Prandaj, Gjykatës i kërkojmë që të vlerësojë situatën për të ardhmen e parashtruesit dhe familjes së tij, pasi parashtruesi i kërkesës është mbajtës i familjes dhe vështirësitë në risocializimin e tij pas përfundimit të procedurave do të vështirësonin edhe ekzistencën e familjes, e cila që tani është e rënduar për shkak të burgimit që disa vite të parashtruesit."*
129. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili parasheh: *"Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik,*

duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. Gjykata me shumicë votash autorizon mos-zbulimin e identitetit ose e jep atë pa një kërkesë nga një palë. Kur lejohet mos-zbulimi i identitetit nga Gjykata, pala duhet të identifikohet vetëm me iniciale ose me shkurtesa apo me një shkronjë të vetme."

130. Gjykata, duke ju referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës sa më sipër, vlerëson se kërkesa për mos-zbulim të identitetit është e pabazuar. Rrjedhimisht, Gjykata refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për moszbulim të identitetit të tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 32 (6), 39 (1)(b) dhe (2), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 25 maj 2023:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË njëzëri kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJ me shumicë kërkesën për mos zbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani